



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/36

Datë: 19.10.2020


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndalohet organizimi i punëtorive jashtë Republikës së Kosovës nga të gjitha Ministrinë, Agjencitë Ekzekutive dhe njësitë tjera brenda sistemit ministror të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për të gjitha aktivitetet që ndërlidhen me hartimin, punimin apo diskutimin e dokumenteve qeveritare përfshirë strategjitë, koncept dokumentet, projekt aktet normative, dokumentet planifikuese dhe të gjitha dokumentet e ngjashme.
2. Ndalohet pjesëmarrja e zyrtarëve publik të punësuar në Ministrinë, Agjencitë Ekzekutive dhe njësitë tjera brenda sistemit ministror të Qeverisë së Republikës së Kosovës në punëtoritë që organizohen jashtë Republikës së Kosovës nga donatorët organizatat tjera, që ndërlidhen me aktivitetet për hartimin, punimin apo diskutimin e dokumenteve qeveritare përfshirë strategjitë, koncept dokumentet, projekt aktet normative, dokumentet planifikuese dhe të gjitha dokumentet e ngjashme.
3. Kur konsiderohet e nevojshme dhe e domosdoshme, aktivitetet e përmendura në pikën 1. dhe 2. të këtij vendimi, mund të organizohen brenda territorit të Republikës së Kosovës, pas autorizimit nga Zyrtaret Kryesor Administrativ të organizatave buxhetore dhe Zyrtarët Kryesor Administrativ të Agjencive Ekzekutive, pjesë e një organizate buxhetore.
4. Autorizohet Ministrija e Ministrisë së Financave që me vendim të veçantë të përcaktojë tarifat e shpenzimeve ditore (shpenzime të imta - para xhepi) për udhëtime brenda vendit dhe kriteret të nevojshme për zbatimin e tyre në organizimet brenda Republikës së Kosovës, sipas pikës 3. të këtij vendimi.
5. Rekomandohet që kufizimet e këtij vendimi të respektohet nga të gjitha organizatat buxhetore që financohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës, pavarësisht nga statusi dhe organizimi i tyre.
6. Ftohen donatorët dhe organizatat tjera (të huaja dhe vendore) që të respektojnë dhe mirëkuptojnë kufizimin sipas këtij vendimi, dhe punëtoritë e specifikuar në paragrafin 1 të këtij vendimi t'i organizojnë brenda territorit të Republikës së Kosovës.
7. Obligohen të gjitha Ministrinë, Agjencitë Ekzekutive dhe njësitë tjera brenda sistemit Ministror për zbatimin e këtij Vendimi.

8. Ky vendim shfuqizon vendimin Nr. 11/12, e datës 20.03.2008 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
9. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë